




NJË SHEKULL ROJE NË DET: FORCA DETARE SHQIPTARE MES HISTORISË, SAKRIFICËS DHE ALEANCËS EUROATLANTIKE

» faqe 3



URDHRI I SKËNDERBEUT - NJË SHEKULL, TRE EMRA, NJË MISION MIRËNJOHJA SHTETËRORE PËR SHËRBBIMIN E SHQUAR NDAJ REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në kuadër të përvjetorit të njëqindtë të themelimit të Urdhrit të Skënderbeut, Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve të Republikës së Shqipërisë, nën kujdesin e Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit, organizoi një ceremoni solemne nderimi, e cila shënoi një moment të veçantë në jetën institucionale...



faqe 6



SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM VLERËSON BASHKËPUNIMIN ME ATASHETË USHTARAKË TË NATO-S, BE-SË DHE VENDEVE PARTNERE

Në kuadër të takimit përmbyllës vjetor me atashetë ushtarakë rezidentë dhe jo-rezidentë të shteteve anëtare të NATO-s, Bashkimit Evropian dhe vendeve partnere, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, shprehu vlerësimin e veçantë për kontributin dhe angazhimin profesional...



faqe 4



NË SHËRBBIM TË JETËS NË DET, REPORTAZH NGA JETA E NJERËZVE TË DETIT, NË FORCËN DETARE SHQIPTARE

Nga brigjet e Adriatikut deri në hapësirat e hapura të Jonit, Forca Detare Shqiptare mbetet një shtyllë e sigurisë kombëtare. Por përtej anijeve, radarëve dhe uniformës blu, qëndrojnë njerëzit - ushtarakët detarë – të cilët çdo ditë balancojnë jetën personale me një profesion që nuk njeh orar, stinë apo kompromis. Deti, vend pune dhe mënyrë...



faqe 5

Forca Tokësore me drejtim të ri: Vazhdimësi misioni dhe përgjegjësi ndaj atdheut

Në Forcën Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë u zhvillua ceremonia e ndërrimit të komandës, një moment me rëndësi institucionale që shpreh vazhdimësinë e misionit dhe përgjegjësinë e pandërprerë për mbrojtjen e vendit.

Ndërrimi i komandës nuk përfaqëson thjesht një akt formal, por është një proces natyror dhe funksional i strukturave ushtarake, ku përvoja, përgjegjësia dhe autoriteti kalojnë nga një dorë e sprovuar te një tjetër, duke garantuar stabilitet dhe koherencë në drejtimin e Forcës Tokësore. Gjatë ceremonisë u shpreh mirënjohje për gjeneralmajor Ilir Xhebexhinë për shërbimin, përkushtimin dhe kontributin e dhënë

në drejtimin e Forcës Tokësore, në një periudhë sfiduese për sigurinë kombëtare dhe rajonale. Nën drejtimin e tij, Forca Tokësore ka vijuar proceset e modernizimit, rritjes së gatishmërisë operative dhe përmbushjes së detyrimeve në kuadër të NATO-s.

Në të njëjtën kohë, detyra e komandantit të Forcës Tokësore i është besuar gjeneralmajor Petrit Çunit, të cilit iu urua suksese në këtë mision të rëndësishëm dhe të vazhdueshëm. Drejtimi i Forcës Tokësore kërkon vizion, profesionalizëm dhe vendimmarrje të përgjegjshme, në funksion të garantimit të sigurisë së Republikës së Shqipërisë dhe kontributit të saj në arkitekturën euroatlantike të mbrojtjes.

U theksua se çdo komandant ndërton mbi punën e paraardhësit, duke forcuar më tej kapacitetet njerëzore dhe operative të Forcës Tokësore, me synimin që ajo të jetë çdo ditë më e gatshme, më profesionale dhe më e besueshme përballë sfidave të sigurisë, si brenda vendit ashtu edhe në angazhimet ndërkombëtare.

Forca Tokësore mbetet një nga shtyllat kryesore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me rol të pazëvendësueshëm në mbrojtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial, si dhe në përmbushjen e detyrimeve ndaj Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Gazeta "Ushtria" do të vijojë të pasqyrojë me përgjegjësi dhe profesionalizëm zhvillimet institucionale në Forcat e Armatosura, duke vlerësuar kontributin e çdo drejtuesi dhe duke promovuar frymën e vazhdimësisë dhe shërbimit ndaj atdheut.



Kontingjenti shqiptar merr pjesë në "Winter Festival" në Camp Butmir, në mbështetje të fëmijëve me aftësi ndryshe

Në ambientet e Bazës së EUFOR-it, Camp Butmir, në Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, u zhvillua aktiviteti humanitar "Winter Festival", me qëllim mbledhjen e fondeve për donacion në Qendrën e Fëmijëve me Aftësi ndryshe.

Në këtë veprimtari me karakter solidariteti dhe bashkëpunimi ndërkombëtar morën pjesë trupa nga kontingjente të ndryshme të EUFOR-it, përfshirë edhe kontingjentin shqiptar, i cili u prezantua denjësisht me standin e tij kombëtar.

Stenda shqiptare u prit me interes nga pjesëmarrësit, duke ofruar produkte dhe elementë përfaqësues të traditës dhe kulturës shqiptare, ndërsa personeli i kontingjentit kontribuoi aktivisht në realizimin e qëllimit humanitar të aktivitetit. Pjesëmarrja në "Winter Festival" ishte një mundësi e mirë për të forcuar bashkëpunimin mes kontingjenteve partnere, si dhe për të promovuar vlerat e solidaritetit, humanizmit dhe përgjegjësisë sociale.

Ky aktivitet dëshmon edhe një herë angazhimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare, jo vetëm në aspektin operacional, por edhe në përmbushjen e rolit humanitar dhe social, në mbështetje të komuniteteve vendase ku shërbejnë.

Forcat e Armatosura shqiptare vijnë të përfaqësojnë vendin me dinjitet në misionin EUFOR ALTHEA, duke kontribuar në ruajtjen e paqes, sigurisë dhe forcimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërkombëtar.





NJË SHEKULL ROJE NË DET: FORCA DETARE SHQIPTARE MES HISTORISË, SAKRIFICËS DHE ALEANCËS EUROATLANTIKE

Forca Detare Shqiptare kremton 100-vjetorin e krijimit të saj

Shqipëria kremtoi me ceremoni zyrtare 100-vjetorin e krijimit të Forcës Detare, një rrugëtim shekullor që nisi, më 25 dhjetor 1925, kur Parlamenti shqiptar i kohës miratoi blerjen e dy anijeve të para ushtarake, “Shqipëria” dhe “Skënderbeg”, duke hedhur themelet e marinës ushtarake shqiptare.

Ceremonia solemne u zhvillua në Portin e Durrësit, ku u mbledhën autoritetet më të larta të shtetit, Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji si dhe drejtues të Forcave të Armatosura, përfaqësues të trupit diplomatik, oficerë, nënoficerë, detarë dhe veteranë të Forcës Detare. Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, vlerësoi kontributin shekullor të Forcës Detare, duke u ndalur edhe në periudhat e vështira të zhvillimit të saj. “Për një kohë të gjatë kemi menduar më ngushtë dhe kemi vepruar më ngadalë sesa kërkonte realiteti ynë detar. Kjo ka qenë një vonesë, madje një gabim strategjik”, - u shpreh ministri Vengu. Gjithashtu ministri Vengu prezantoi strategjinë “Mbrojtja 2030”, e cila synon një modernizim rrënjësor të Forcës Detare, të mbështetur mbi pesë shtylla kryesore. Prioritetet përfshijnë: trajnimin dhe rritjen e pagave për ekuipazhet profesioniste; ndërtimin dhe mirëmbajtjen e anijeve në bazën detare të Pashalimanit, për të garantuar autonomi reale; fokusimin në kapacitete reale operacionale dhe jo simbolike; zhvillimin e Porto-Romanos si nyje sigurie për NATO-n; modernizimin e Rojës Bregdetare si linjë e parë e mbrojtjes së sovranitetit detar.

Një histori 100-vjeçare shërbimi dhe transformimi

Përpjekja e parë për krijimin e një marine ushtarake shqiptare daton më 25 dhjetor 1925. Pas viteve '90, Forca Detare, ashtu si e gjithë Forca e Armatosur e Republikës së Shqipërisë, iu nënshtrua një procesi të thellë reformimi dhe modernizimi, duke u përshtatur me standardet e NATO-s për përmbushjen e misionit kushtetues.

Sot, Forca Detare vijon modernizimin e flotës me anije të reja luftarake, mjete multifunkionale, si dhe kapacitete për luftën kundër minave dhe gjurmimin nënujor. Prej më shumë se gjashtë vitesh, ajo është pjesëmarrëse e vlerësuar në misionin e NATO-s në Detin Egje, me një anije patrulluese.

Ruajtja e sovranitetit të hapësirës detare të Republikës së Shqipërisë, në bashkëveprim me strukturat e tjera



të Forcave të Armatosura dhe NATO-n, si dhe zbatimi i ligjit kombëtar dhe ndërkombëtar në det, mbeten detyra themelore të kësaj force.

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, nderoi detarë, nënoficerë, oficerë dhe veteranë për shërbimin e tyre me devotshmëri ndaj atdheut.

Në fjalën e tij, Kreu i Shtetit theksoi rrugëtimin historik të Forcës Detare, nga patrullimi me anijet “Shqypëria” dhe “Skënderbeg”, deri te përfshirja aktive në sigurinë euroatlantike.

“Forca Detare është rritur, zhvilluar, transformuar dhe modernizuar, duke reflektuar në rrugëtimin e saj historinë e vetë vendit. Ajo i ka qëndruar gjithmonë besnike atdheut, rojtare e palëkundur e sovranitetit dhe mbrojtëse e interesave kombëtare në hapësirën detare”, deklaroi Presidenti Begaj.

Presidenti Begaj shprehu mirënjohje për mbështetjen e aleatëve, veçanërisht Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Italisë, Holandës, Turqisë dhe partnerëve

të tjerë të NATO-s, në ndërtimin e kapaciteteve bashkëkohore operacionale.

Forca Detare dhe sfidat e sigurisë bashkëkohore

Presidenti Begaj vlerësoi angazhimin e Forcës Detare në operacionet e NATO-s, si “Aegean Sea” dhe “FOCOPS”, duke i cilësuar si dëshmi të zgjedhjes strategjike të Shqipërisë për të garantuar sigurinë përmes bashkëpunimit dhe besueshmërisë me aleatëve.

“Dinamikat gjeopolitike, format e reja të kërcënimeve, trafiku i paligjshëm dhe tensionet në hapësirën mesdhetare bëjnë të domosdoshme një Forcë Detare të aftë për të vepruar me shpejtësi, profesionalizëm dhe besueshmëri”, - u shpreh Kreu i Shtetit.

Ai theksoi rëndësinë e investimeve për modernizimin e mëtejshëm të Forcës Detare, zhvillimin e infrastrukturës portuale, modernizimin e kantierëve të ndërtimit dhe riparimit të anijeve, si dhe thellimin e bashkëpunimit me aleatët, si kusht për garantimin e sovranitetit detar dhe sigurisë kombëtare.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm vlerëson bashkëpunimin me atashetë ushtarakë të NATO-s, BE-së dhe vendeve partnere

Në kuadër të takimit përmbyllës vjetor me atashetë ushtarakë rezidentë dhe jo-rezidentë të shteteve anëtare të NATO-s, Bashkimit Evropian dhe vendeve partnere, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, shprehu vlerësimin e veçantë për kontributin dhe angazhimin profesional të secilit prej tyre në forcimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit ushtarak.

Gjenerallejtënant Kingji theksoi se bashkëpunimi dypalësh, rajonal dhe shumëpalësh, si dhe ai në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut, ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërveprueshmërisë dhe zhvillimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Sipas tij, ky bashkëpunim mbetet thelbësor për procesin e modernizimit dhe rritjen e kapaciteteve operative të FA-së, në funksion të përmbushjes së standardeve



të NATO-s dhe të përmbushjes së angazhimeve për ruajtjen e sigurisë kombëtare dhe asaj kolektive. Në përfundim të takimit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm riafirmoi gatishmërinë e Forcave të Armatosura për të vijuar dhe thelluar më tej bashkëpunimin me partnerët dhe aleatët strategjikë, duke kontribuar në mënyrë aktive për paqen dhe stabilitetin në rajon dhe më gjerë.



Zall-Herr, stërvitje shumëkombëshe e ORF të KFOR-it për rritjen e gatishmërisë operative

Në Zall-Herr, Shtabi i Forcës së Rezervës Operacionale (ORF) të KFOR-it, i përbërë nga efektivë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Bullgarisë, Greqisë dhe Rumanisë, po zhvillon një stërvitje të përqendruar në planifikimin, drejtimin dhe menaxhimin e operacioneve sipas skenarëve të ndryshëm në zonën e operacionit. Gjatë aktivitetit stërvitor, personeli shumëkombësh po trajnohet mbi procedurat e komandimit dhe kontrollit, koordinimin ndërmjet strukturave dhe reagimin operacional ndaj situatave të ndryshme, në përputhje me standardet e NATO-s. Këto stërvitje synojnë rritjen e ndërveprueshmërisë mes forcave pjesëmarrëse, forcimin e bashkëpunimit shumëkombësh dhe garantimin e një përgjigjeje të shpejtë, të koordinuar dhe efektive ndaj çdo situatë të mundshme, në mbështetje të misionit të KFOR-it për ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë. Angazhimi i Forcave të Armatosura shqiptare në këtë stërvitje dëshmon profesionalizmin dhe kontributin e tyre të vazhdueshëm në operacionet paqeruajtëse ndërkombëtare dhe përkushtimin ndaj sigurisë rajonale dhe euroatlantike.



Forcat e Armatosura thellojnë bashkëpunimin me Italinë në fushën e mjeteve ajrore pa pilot (UAV)

Vijon bashkëpunimi i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me palën italiane edhe në fushën e mjeteve ajrore pa pilot (UAV), në kuadër të forcimit të kapaciteteve operative dhe rritjes së nivelit të profesionalizmit të personelit.

Në këtë kuadër, një delegacion i Forcave të Armatosura shqiptare, i kryesuar nga kolonel Sulo Mustafaraj dhe nënkolonel Eljo Buçka, zhvilloi një vizitë pune në Qendrën e Ekselencës për Mjetet Ajrore të Komanduara në Distançë të Forcave të Armatosura italiane.

Gjatë takimeve dhe prezantimeve të realizuara, fokusi kryesor ishte shkëmbimi i përvojave dhe njohurive profesionale, si dhe njohja me praktikën më të avancuar të trajnimit dhe përdorimit të sistemeve UAV. Palët diskutuan mbi standardet bashkëkohore të trajnimit, procedurat operative dhe mundësitë për përfshirjen e personelit shqiptar në programe të specializuara trajnuese në këtë fushë.

Bashkëpunimi me Italinë në këtë sektor strategjik vlerësohet si një hap i rëndësishëm në procesin e modernizimit të Forcave të Armatosura dhe në përafrimin e mëtejshëm me standardet e NATO-s, duke rritur aftësitë për vëzhgim, zbulim dhe mbështetje operative.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbeten të angazhuara në forcimin e partneriteteve strategjike me vendet aleate, në funksion të garantimit të sigurisë kombëtare dhe rritjes së ndërveprueshmërisë në misione të përbashkëta.



Batalioni i Xhenios realizon detyrën në shërbim të komunitetit

Specialistët e Kompanisë së Urave, pjesë e Batalionit të Xhenios, përfunduan me sukses ndërtimin e një ure metalike tip "Bailey" në fshatin Qafzezë, Bashkia Ersekë, duke kontribuar drejtpërdrejt në përmirësimin e infrastrukturës lokale dhe jetës së komunitetit.

Ura e ndërtuar ka një gjatësi prej 18 metrash dhe kapacitet peshëmbajtjeje deri në 40 ton, duke garantuar kalim të sigurt për automjetet dhe këmbësorët. Ajo shërben si një nyje lidhëse mjaft e rëndësishme për zonën, pasi siguron aksesin e rregullt për 12 fshatra të kësaj bashkie dhe lehtëson kryerjen e aktiviteteve të përditshme për rreth 1500 banorë.

Ky angazhim i Batalionit të Xhenios dëshmon edhe një herë rolin e rëndësishëm të Forcave të Armatosura jo vetëm në përmbushjen e misionit kushtetues të mbrojtjes, por edhe në mbështetjen e komuniteteve, veçanërisht në zonat rurale, duke garantuar siguri, akses dhe zhvillim të qëndrueshëm. Forcat e Armatosura vijojnë të jenë pranë qytetarëve, në shërbim të interesit publik dhe të mirëqenies së komunitetit.



Në shërbim të jetës në det

Reportazh nga jeta e njerëzve të detit, në Forcën Detare Shqiptare

Nga brigjet e Adriatikut deri në hapësirat e hapura të Jonit, Forca Detare Shqiptare mbetet një shtyllë e sigurisë kombëtare. Por përtej anijeve, radarëve dhe uniformës blu, qëndrojnë njerëzit - ushtarakët detarë – të cilët çdo ditë balancojnë jetën personale me një profesion që nuk njeh orar, stinë apo kompromis.

Deti, vend pune dhe mënyrë jetese

Për ushtarakët detarë, deti nuk është thjesht një mjedis operacional. Ai është një mënyrë jetese, një realitet i përditshëm që formëson karakterin, disiplinën dhe sakrificën. Ndryshe nga shumë profesione të tjera ushtarake, shërbimi në det kërkon një lidhje të veçantë shpirtërore me mjedisin natyror, ku çdo gabim mund të ketë pasoja serioze.

Në Bazën Detare të Durrësit dhe atë të Pashalimanit, dita nis herët. Përgatitja teknike e mjeteve lundruese, kontrolli i sistemeve të navigimit, komunikimit dhe sigurisë është rutinë e pandashme. Por pas kësaj rutine qëndron një përgjegjësi e madhe: garantimi i sovranitetit detar, mbrojtja e hapësirës ujore dhe përmbushja e detyrimeve ndaj NATO-s.

Mes familjes dhe misionit

Një nga sfidat më të mëdha për ushtarakët detarë mbetet ndarja e shpeshtë nga familja. Misionet detare, stërvitjet e zgjatura dhe gatishmëria e përhershme i mbajnë ata larg shtëpisë për ditë, javë apo muaj.

“Kur je në det, mendja të shkon gjithmonë te familja, por në të njëjtën kohë e di që ke një detyrë për të përmbushur”, - shprehet një nënoficer me mbi 15 vite shërbim.

“Fëmijët rriten, ngjarjet familjare kalojnë, dhe ti shpesh i përjeton nga larg. Është sakrificë, por edhe krenari”.

Bashkëshortet dhe familjet e ushtarakëve detarë janë pjesë e heshtur e këtij shërbimi. Ato mbajnë barrën e përditshmërisë, duke përballuar mungesën, pasigurinë dhe pritjen e gjatë.

Profesionalizëm në kushte të vështira

Deti nuk është gjithmonë i qetë. Kushtet atmosferike, stuhitë, dallgët e larta dhe izolimi psikologjik janë pjesë e realitetit të përditshëm. Në këto kushte, profesionalizmi dhe përgatitja e lartë bëhen jetike.

Forca Detare Shqiptare ka investuar ndjeshëm në trajnimin e personelit, brenda dhe jashtë vendit. Pjesëmarrja në stërvitje të përbashkëta me aleatët e NATO-s ka rritur ndjeshëm standardet operationale dhe ndërveprimin ndërkombëtar.

Ushtarakët detarë shqiptarë kanë treguar aftësi të larta në:

- patrullimin detar
- operacionet e kërkim-shpëtimit
- luftën kundër trafikeve të paligjshme
- operacionet humanitare

Këto misione kërkojnë vendimmarrje të shpejtë, koordinim dhe besim të ndërsjellë mes ekuipazhit.

Jeta në bord, disiplinë dhe solidaritet

Jeta në bord të një anijeje ushtarake është një mikrokozmos më vete. Hapësira të kufizuara, orare



strikte dhe bashkëjetesë e vazhdueshme kërkojnë disiplinë të lartë dhe respekt reciprok.

Në det, gradat respektohen, por solidariteti njerëzor është ai që mban ekuipazhin të bashkuar. Çdo marinar, oficer apo nënoficer ka një rol të pazëvendësueshëm.

“Kur je në det, nuk ka rëndësi vetëm grada, por besimi tek shoku pranë”, - thotë një oficer i ri. “E di që në çdo situatë, ai do të jetë aty”.

Teknologjia dhe sfidat e reja

Epoka moderne ka sjellë sfida të reja për Forcën Detare. Monitorimi elektronik, siguria kibernetike, përdorimi i dronëve detarë dhe integrimi në sistemet e përbashkëta të NATO-s kërkojnë njohuri

të avancuara teknike.

Ushtarakët detarë sot nuk janë vetëm marinarë, por edhe operatorë sistemesh komplekse. Kjo kërkon arsimim të vazhdueshëm dhe përshtatje të shpejtë me zhvillimet teknologjike.

Krenaria e uniformës blu

Pavarësisht vështirësive, ushtarakët detarë mbajnë me krenari uniformën blu. Ajo përfaqëson jo vetëm profesionin, por edhe besimin e shtetit dhe të qytetarëve shqiptarë. Çdo dalje në det, çdo flamur i ngritur në kuvertë, është një akt simbolik i sovranitetit dhe përgjegjësisë kombëtare.

Mes sakrificës dhe shpresës

Reportazhi për ushtarakët detarë nuk mund të jetë i plotë pa përmendur shpresën për të ardhmen. Brezat e rinj që i bashkohen Forcës Detare sjellin energji, dije dhe vizion të ri. Ata trashëgojnë përvojën e brezave të mëparshëm dhe ndërtojnë një Forcë Detare moderne, profesionale dhe të denjë për sfidat e shekullit XXI. Ushtarakët detarë janë ndër kategoritë më pak të dukshme, por më të rëndësishme të Forcave të Armatosura. Ata jetojnë mes dy botëve: jetës familjare dhe detyrimit profesional, mes tokës dhe detit, mes sakrificës dhe krenarisë.

Ky reportazh është një homazh për njerëzit e detit, për ata që në heshtje ruajnë kufijtë blu të Shqipërisë dhe përmbushin misionin me dinjitet, profesionalizëm dhe dashuri për atdheun.





URDHRI I SKËNDERBEUT

NJË SHEKULL, TRE EMRA, NJË MISION

Mirënjohja shtetërore për shërbimin e shquar ndaj Republikës së Shqipërisë



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

REPUBLIKA E SHQIPËRISË URDHRI I SKËNDERBEUT NË QINDVJETORIN E THEMELIT

Në kuadër të përvjetorit të njëqindtë të themelimit të Urdhrit të Skënderbeut, Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve të Republikës së Shqipërisë, nën kujdesin e Presidentit të Republikës dhe Kryeministrit, organizoi një ceremoni solemne nderimi, e cila shënoi një moment të veçantë në jetën institucionale dhe morale të shtetit shqiptar.

Ky aktivitet përbën një akt zyrtar të rikthimit dhe riafirmimit të traditës së vlerësimit shtetëror të meritës, veçanërisht në fushën e shërbimit ushtarak, si një nga shtyllat themelore të sigurisë, sovranitetit dhe rendit kushtetues të Republikës së Shqipërisë.

Urdhri i Skënderbeut, Kuari historik dhe institucional

Urdhri i Skënderbeut, i themeluar në vitin 1925, përfaqëson një nga dekoratat më të larta të shtetit shqiptar.

Ai mban emrin e Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu dhe simbolizon virtytet e:

- besnikërisë ndaj atdheut,
- trimërisë dhe guximit moral,
- sakrificës për interesin publik,
- shërbimit të dalluar ndaj kombit.

Gjatë një shekulli ekzistence, Urdhri i Skënderbeut ka qenë instrument i rëndësishëm i politikës së nderimit shtetëror, duke kontribuar në ndërtimin e kujtesës institucionale dhe në edukimin qytetar përmes shembujve të shërbimit të lartë.

Dimensioni shtetëror i ceremonisë së qindvjetorit

Ceremonia e organizuar me rastin e qindvjetorit të Urdhrit të Skënderbeut kishte karakter të theksuar institucional dhe simbolik. Ajo shërbeu për të:

- riafirmuar rolin e urdhrave shtetërorë në jetën publike,
- rikthyer në qendër të vëmendjes parimin e mirënjohjes si akt drejtësie shtetërore,

- vlerësuar figura të shquara që kanë kontribuar në forcimin e shtetit dhe institucioneve të tij.

Në këtë kuadër, u realizua dekorimi i ushtarakëve të Forcave të Armatosura, si shprehje e respektit dhe vlerësimit të shtetit shqiptar ndaj shërbimit ushtarak.

Forcat e Armatosura dhe shërbimi ndaj shtetit

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përbëjnë një institucion themelor të sigurisë kombëtare. Ato janë ndërtuar mbi parimet e:

- ligjshmërisë,
- disiplinës ushtarake,
- profesionalizmit,
- përgjegjësisë ndaj popullit dhe Kushtetutës.

Në këtë kuadër, vlerësimi i oficerëve dhe gjeneralëve me dekorata të larta shtetërore përfaqëson një akt njohjeje institucionale të kontributit të tyre në mbrojtjen e interesave kombëtare dhe në përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë.



TRE FIGURA – NJË BOSHT VLERE KOMBËTARE



ALFRED MOISIU,
ish-Ushtarak, ish-President i Republikës dhe
Figurë Themelore e Shtetit Modern Shqiptar

Në kuadër të ceremonisë së qindvjetorit të Urdhrit të Skënderbeut, vlerësimi i figurës së Alfred Moisiut përbën një akt me rëndësi të veçantë institucionale dhe historike, duke ndërthurur në një personazh të vetëm shërbimin ushtarak, përgjegjësinë shtetërore dhe udhëheqjen politike në funksion të interesit kombëtar.

Alfred Moisiu i përket brezit të oficerëve profesionistë që e kanë nisur jetën e tyre publike në radhët e Forcave të Armatosura, duke u formuar mbi parimet e disiplinës, korrektësisë dhe përgjegjësisë ndaj shtetit. Karriera e tij ushtarake përbën themelin



GJENERAL ZYBER DUSHKU
Urdhri i Skënderbeut – Grada “Komandant”

Gjeneral Zyber Dushku u dekorua me Urdhrin e Skënderbeut në gradën “Komandant”, në vlerësim të një karriere të gjatë dhe të qëndrueshme në shërbim të Forcave të Armatosura dhe të shtetit shqiptar.

Gjatë ushtrimit të detyrave të tij, Gjeneral Dushku ka kontribuar në:

- drejtimin dhe konsolidimin e strukturave ushtarake,
- rritjen e standardeve profesionale dhe etike,
- forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe ndërkombëtar.

Figura e tij karakterizohet nga integriteti moral, korrektësia profesionale dhe aftësia për të udhëhequr me përgjegjësi dhe maturi, duke mishëruar standardet më të larta të shërbimit ushtarak.



KOLONEL AJETA JATA
Urdhri i Skënderbeut – Grada “Kalorës”

Kolonel Ajeta Jata u dekorua me Urdhrin e Skënderbeut në gradën “Kalorës”, si shenjë vlerësimi për kontributin e tij të dalluar në shërbimin ushtarak dhe përkushtimin e vazhdueshëm ndaj detyrës.

Ai përfaqëson modelin e oficerit profesionist, të përkushtuar ndaj misionit, të formuar mbi parimet e disiplinës, korrektësisë dhe përgjegjësisë institucionale. Veprimtaria e tij ka qenë e orientuar drejt përmbyshjes me sukses të detyrave të besuara, në funksion të sigurisë kombëtare dhe interesit publik.

Dekorimi i Gjeneral Zyber Dushkut dhe Kolonel Ajeta Jates me Urdhrin e Skënderbeut përbën një akt zyrtar të mirënjohjes shtetërore dhe një kontribut të rëndësishëm në ruajtjen e kujtesës institucionale të Republikës së Shqipërisë.

Ky akt shërben si referencë për brezat e ardhshëm të Forcave të Armatosura dhe si dëshmi e vlerave mbi të cilat ndërtohet shërbimi publik.

Në përmbyllje, ceremonia e qindvjetorit të Urdhrit të Skënderbeut riafirmoi rëndësinë e nderimit shtetëror si akt drejtësie, përgjegjësie dhe vazhdimësie institucionale.

Vlerësimi i ushtarakëve të shquar të Forcave të Armatosura përbën një shprehje të qartë të angazhimit të shtetit shqiptar për të ruajtur dhe promovuar standarde të larta morale, profesionale dhe qytetare në shërbim të Republikës dhe të së ardhmes së saj europiane.



mbi të cilin u ndërtua më pas roli i tij si burrë shteti.

Si ish-President i Republikës së Shqipërisë dhe njëkohësisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Alfred Moisiu luajti një rol kyç në një nga periudhat më delikate të konsolidimit institucional të vendit, duke garantuar:

- stabilitet kushtetues,
- depolitizimin dhe profesionalizimin e Forcave të Armatosura,
- forcimin e rolit të ushtrisë si institucion i shtetit dhe jo i radhës politike,
- orientimin e qartë euroatlantik të Shqipërisë në fushën e sigurisë.

Kontributi i Alfred Moisiut vlerësohet jo vetëm për funksionet e mbajtura, por për etikën e shërbimit publik që ai përfaqësoi. Ai mishëron modelin e ish-ushtarakut që e transferon disiplinën dhe korrektësinë e uniformës në drejtimin e shtetit.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve**Shtypi Ushtarak në 94 Vite: Arkivi i Mbretërisë, Luftës, Ushtrisë dhe NATO**

Shtypi ushtarak në Shqipëri është më shumë se thjesht një instrument informimi, ai është arkivi i gjallë i mbrojtjes kombëtare, pasqyra e transformimeve të Forcave të Armatosura dhe ura lidhëse midis institucionit të ushtrisë dhe qytetarëve.

Nga “Rivista Ushtarake” (1931) e deri tek revista “Mbrojtja” (botim modern, pas vitit 1997), shtypi ushtarak shqiptar ka dokumentuar:

- ngritjen e Ushtrisë Kombëtare,
- përpjekjet e brezave të ushtarakëve,
- zhvillimet teknike, organizative dhe doktrimore,
- pjesëmarrjen në NATO dhe misionet paqeruajtëse,
- trashëgiminë e historisë sonë të rezistencës dhe lirisë.

“Historia e ushtrisë shkruhet çdo ditë, por vetëm shtypi ushtarak ia jep asaj kujtesën”

“Rivista Ushtarake” – GURTHEMELI I SHTYPI USHTARAK SHQIPTAR

Shtypi ushtarak e ka zanafillën e vet në majin e vitit 1931, kur dritën e botimit e pa numri i parë i revistës ushtarake, “Buletini dhe e përkohshmja ushtarake”.

Kjo ishte e para revistë ushtarake në Shqipëri gjatë gjithë historisë 113-vjeçare të Ushtrisë Shqiptare. Në faqet e saj zunë vend artikuj të ndryshëm që kishin të bënin për ushtrinë, reformat, organizimin, protagonistët dhe modernizimin e saj, njëkohësisht u trajtuan edhe probleme teorike të ushtrisë, të teknikës ushtarake si dhe ngjarje dhe lajme të huaja. Revista dëlte një herë në muaj dhe u quajt e përkohshme.

Ajo kishte një staf që fillonte me drejtorin, redaksinë dhe administratën, të cilat gjendeshin pranë Komandës së Mbrojtjes Kombëtare. Revista doli me 24 faqe. Më pas në kohë, vendin e saj e zuri “Rivista ushtarake” me 60 faqe, që ishte

vazhdim i saj. U botuan numrat 78-91, vetëm në gjuhën shqipe.

Botime kryesore të kësaj periudhe

Ndërsa në vitet e Luftës së Dytë Botërore kryesisht shtypi ushtarak, nëse mund të quhej kështu, u përbë nga gazetatat e botuara nga shumë formacione luftarake partizane si “Përpara në sulm”, “Buçitja”, “Ylli çlirimtar”, “Pishtari”, “Zëri i luftëtarit”, “Horizonti në ndriçim”, “Përpara”, “Zëri i të riut”, të cilat kishin kryesisht karakter politik por edhe disi ushtarak. Autorë, që me shkrimet e tyre mbushën këtë shtyp, ishin kryesisht Xhemil Frashëri, Andrea Varfi, Hamdi Sallaku, Haki Stërmilli, Shefqet Musarai etj, që më vonë u bënë shkrimtarë të njohur. Këta ishin gazetarët e parë të shtypit të luftës të viteve ’43-’44. Pjesë e këtij shtypi ishte edhe gazeta “Mundimi”, organi politik, propagandistik i aviacionit ushtarak britanik e amerikan, botohej e përjavshme me dy

KRONIKA E MBROJTJES: 94 Vjet Histori dhe Identitet Ushtarak në Pasqyrën e Shtypit

SHTYPI USHTARAK SHQIPTAR NË VITE (1931–2025)

Rruga e Doktrínës, Edukimit dhe Komunikimit Ushtarak në 94 Vjet Histori



faqe. Gazeta më tepër ishte informative dhe botohej në Bari, por shpërndahej në Shqipëri.

Në vitin 1945 dolën dhe organet e para ushtarake, “Luftëtari” numri i parë doli në tetor 1944 në Tiranë. Gazeta ishte me katër faqe, në të cilat i bëhej jehonë ushtrisë partizane, luftës për çlirimin e Tiranës dhe gjithë Shqipërisë. Ndërsa gazeta me këtë emër doli rregullisht që nga maji i vitit 1945, si organ i Ministrisë së Mbrojtjes Kombëtare duke mbetur në thelb një gazetë ushtarake, me praktika, me probleme të ditës dhe kryesisht ushtarake.

Gazeta e pushoi jetën e saj në vitin 1991, në kohën e ndryshimeve të mëdha demokratike që ndodhën në vend, për të vazhduar më tej me ushtrinë. Më pas u vijua botimi i saj, me tituj të ndryshëm, si “Ushtria dhe Koha” dhe që nga viti 1997 u titullua “Ushtria”

Në fund të viteve ’40, shtypit ushtarak të shkruar, iu shtua edhe Revista “10 Korriku”, e cila ishte një revistë ilustrimi dhe më e afërt dhe më e drejtpërdrejtë me ushtarakët shqiptarë.

Botimi më profesional ushtarak ishte “Revista Ushtarake”, e cila u botua në vitin 1948, si organ i

Ministrisë së Mbrojtjes. Revista trajtonte probleme teorike ushtarake, fjalime politike, tema dhe biseda si dhe tema të ndryshme ndërkombëtare apo edhe tema historike. Më pas vijoi të botohej me tituj të ndryshëm si “Revista ushtarake politike” (1954-1967) apo “Revista politike ushtarake”, fill pas heqjes së gradave në ushtri dhe rivendosjes së komisarëve dhe të komiteteve të partisë në ushtri. Ndërsa revista tjetër e titulluar, “Për mbrojtjen e atdheut” nisi veprimtarinë e saj në vitin 1975, deri në vitin 1991, kur pushoi edhe ajo jetën e saj, e në thelb revista trajtonte po ato probleme dhe njëkohësisht mbeti një propagandiste e pastër e politikës së asaj periudhe për edukimin politiko-ushtarak të kuadrove të lartë.

Sot

Shtypi ushtarak, përfaqësohet nga gazeta “Ushtria” dhe revista “Mbrojtja”. Autorët e shumtë, të shkrimeve të natyrave të ndryshme që kanë botuar por edhe botojnë, në të gjitha organet ushtarake janë pambarimisht në numër, por ne do t’i përkujtojmë

me respekt, ata që janë largur por edhe të tjerët që janë prezent, sepse ata dhanë një frymë të re dhe shumë profesionale, pasi ishin gazetarë të talentuar dhe të përkushtuar për misionin që përmbushën.

Gazetaria i ka shanset të jetojë ekskluzivisht si lajm, duke bllokuar ingranazhet e makinerisë gjigante të internetit, si lajm që mendohet dy herë, para se të shtypet një herë, si lajm, i cili e pranon se lajmi më i mirë nuk është domosdoshmërisht lajmi i parë, si lajm, i cili e bllokon rrjedhën e furishme të lajmeve në eter dhe u tregon lexuesve se çfarë është e rëndësishme e thelbësore. Me këto premisa, fati i shtypit të shkruar në Shqipëri është i sigurt dhe do të mbijetojë, madje duke u përmirësuar në thelb. Shtypi i shkruar do të mbetet në çfarëdolloj forme. Domosdoshmëria e shtypit ushtarak dhe forma që duhet të ketë ai, një traditë që duhet të ketë vijimësi.

Rëndësia për identitetin ushtarak

Revista i dha ushtrisë një gjuhë të përbashkët teknike, rriti kapacitetin profesional të oficerëve dhe krijoi kulturën e parë të botimeve ushtarake shqiptare.

Funksionet themelore

- ngritja e moralit të luftëtarëve,
 - bashkërendimi i aksioneve,
 - informimi mbi zhvillimet e luftës,
 - komunikimi midis strukturave të Komandës së Përgjithshme.
- “Gazeta është arma jonë e heshtur: nuk qëllon, por udhëheq”

Rëndësia e shtypit ushtarak

Ushtria ka nevojë për shtypin e vet, sepse e mban ministrinë e Mbrojtjes në një kontakt shumë të afërt me realitetin dhe me jetën ushtarake. Është pikërisht profesioni i gazetarit që jep lidhjet e plota të mjedisit dhe aktiviteteve, është gazeta ajo që jep në mënyrën më të gjallë atë që ndodh.


Studiuesit e historisë mund t'i referohen këtyre gazetave, ashtu siç edhe e kanë bërë, sepse në gazeta mbetet i fiksuar aktiviteti i ushtrisë dhe ai i një kohe të caktuar.

Një kuadër që drejton ushtrinë mund ta njohë realitetin e jetës ushtarake në mënyra të ndryshme, por padyshim që një mënyrë shumë e mirë dhe efikase është informimi nëpërmjet shtypit. Ky informim mund ta ndihmojë atë për të pasur një perceptim sa më të saktë për ushtrinë.

Në ushtri duhet të ekzistojë patjetër dhe të fuqizohet ndërgjegjja. Ushtri pa pasur ndërgjegje nuk ka, sepse nuk është njëlloj si në mjedisin civil ku mund të paguash për një shërbim të caktuar dhe dikush e bën. Në ushtri ajo që bëhet duhet të jetë e bazuar te ndërgjegjja, pasi në të kundërt nuk do të mund të arriheshin dot objektivat.

Ushtria bazohet në vetitë morale të cilat janë fuqia më e madhe e një ushtrie. Janë bërë studime të panumërta në lidhje me këtë fuqi dhe këtë gjë e ka provuar historia e njerëzimit prej mijëra vjetësh. Kohezioni, forca që e mban një ushtri është morali. Çdo drejtues duhet të studiojë elementin e moralit. Gazeta është një nga format më të mira për këtë lloj drejtimi, pasi artikujt nuk janë thjesht informativë por janë edhe formues. Gazeta nuk niset nga gjëra të këqija, por niset nga shembulli pozitiv. Në shtypin e përditshëm mund të thuhet çdo gjë, por në shtypin ushtarak duhet të ketë një format, i cili nëpërmjet botimeve të shkrimeve t'i shërbejë unitetit, sepse po u cenua uniteti i komandës, po u krijua një opinion i keq për drejtuesit duke përdorur shtypin, atëherë priset kohezioni dhe humbet besimi te komanda.

Të gjitha këto zhvillime duhet të ecin në mënyrë të shëndoshë dhe t'i shërbejnë qëllimit të forcimit ushtarak. Kjo është domosdoshmëria e shtypit



ushtarak dhe forma që duhet të ketë ai. Të gjitha ushtritë kanë traditën e tyre të shtypit, ashtu si dhe ne kemi traditën tonë, e cila është një traditë e lavdishme. Nuk duhet të harrojmë gjenezën tonë dhe mbi të gjitha nuk duhet të harrojmë vlagën patriotike, e cila na bën të jemi shqiptarë. Këtë vlagë duhet të ketë gazetaria ushtarake dhe fryma e ushtrisë duhet të jetë e ushqyer pikërisht me këtë vlagë patriotike.

Shtypi Ushtarak, histori kombëtare

Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare u realizua shtypi, duke vënë edhe kokën në rrezik, dhe kjo që ai të dilte në qarkullim, pasi ishte një armë e fuqishme. Mund të përmendet rasti i UÇK-së, e cila e krijoi shtypin në kulmin e luftës, Agjencia Kosova Press, Radio Kosova e Lirë, gazeta etj., të rrethuar nga serbët, vetëm e vetëm që të jepnin mesazhin e luftës dhe optimizmin e fitores. Pse? Sepse ishte një armë e domosdoshme e pazëvendësueshme, një armë e cila në luftë ka dalë nga gjaku, sepse ka shkruar për ata që dhanë jetën për atdheun, sepse është shkruar në llogore, mes borës e plumbave për të treguar sakrificën njerëzore më sublime, vetëmohimin për tokën e të parëve dhe për gjënë më të shtrenjtë, për lirinë. Nëse do të shkatërrosh një ushtri, shkatërroi moralin, shkatërroi shtypin, informimin dhe formimin edukativ dhe ia ke dalë. Kjo është rëndësia e shtypit: Shtypi është artileri e rëndë e ndërgjegjes...

Në atë kohë nuk kishte gazetarë të mirëfilltë. Për në atë kohë mund të flitet për disa emra të shtypit të kohës së Luftës si: Xhemil Frashëri, Andrea Varfi, Hamdi Sallaku, Haki Stërmilli, Shefqet Musarai etj., që më vonë u bënë edhe shkrimtarë të njohur. Këta ishin gazetarët e parë të shtypit të luftës dhe bëhet fjalë për vitet '43-'44.

Drejtuesit e parë të shtypit ushtarak

Në vitet e para kanë qenë gazetarë emra të tillë si Xhemil Frashëri apo Vasil Gjylameti, një gazetar që vinte nga Lufta, ish-partizan i Brigadës së 3-të Sulmuese, që qëndroi kryeredaktor për një kohë shumë të gjatë. Flitet për vitet '50 deri në '74. Z. Vasil Gjylameti ishte një personalitet i fushës së gazetarisë dhe shtypit ushtarak. Me përvojën dhe autoritetin që kishte përgatiti gjenerata të tëra gazetarësh dhe intelektualësh. Ai la një emër shumë të mirë në shtypin ushtarak. Në vitet '70, pas tij

vjen Fuat Çeliku dhe në këto vite vjen një plejadë gazetarësh të mirëfilltë, ku mund të përmendim: Demokrat Anastasin, Hysni Milloshin, Apostol Dukën, Thanas Tanen etj., të cilët kanë punuar deri në vitet '92. Këta sollën një ndryshim cilësor në gazetarinë ushtarake dhe dhanë një frymë të re dhe shumë profesionale pasi ishin gazetarë të talentuar. Ata kishin dy elementë pozitivë: vinin nga shkolla ushtarake dhe kishin një arsim civil që i ndihmonte në gazetari.

Vazhdimisht gazeta ka qenë e publikuar dy herë në javë, deri në vitet 1992 e më pas publikohet një herë në javë. Revista ka qenë vazhdimisht e publikuar një herë në muaj.

Botime të rinovuara

- “Mbrojtja” (botimi modern fillon rreth 1997)
- Raporte dhe buletine të Ministrisë së Mbrojtjes
- Studime të Qendrës së Sigurisë dhe Politikave të Mbrojtjes

EPOKA NATO (2009–2025)

Shtypi ushtarak si përdorues i standarteve Euroatlantike

Pas anëtarësimit në NATO (2009), shtypi ushtarak u modernizua në përmbajtje, dizajn dhe filozofi komunikimi.

Tematika bashkëkohore

- Operacionet paqeruajtëse në Afganistan, Irak, Bosnje, Mali
- Transformimi i FA-së në forcë të lehtë, të lëvizshme dhe ndërvepruese
- Konceptet e reja të mbrojtjes kolektive
- Kërcënimet e sigurisë kibernetike
- Zhvillimet e programit të modernizimit (“Black Hawk”, P-8, komunikimi satelitor, dronët)

Roli i revistës “Mbrojtja”

- Platforma kryesore kombëtare e mendimit të sigurisë
- Tribunë e ekspertëve, analistëve dhe akademikëve
- Forum profesional i oficerëve dhe i strukturave të MM-së dhe SHP-së
- Arkiv i proceseve të reformimit të mbrojtjes shqiptare

“Në NATO, shtypi ushtarak është instrument strategjik. Në Shqipëri ai është bërë identitet”

“Rruga 94-Vjeçare e Shtypit Ushtarak”

- “10 Funksionet Strategjike të Shtypit Ushtarak”
- Edukim profesional
 - Kulturë sigurie
 - Transparencë
 - Arkiv historik
 - Moral trupash
 - Diplomaci ushtarake
 - Ndërveprim me NATO-n
 - Standardizim doktrinar
 - Dokumentim operativ
 - Marrëdhënie me publikun
- Shtypi Ushtarak: Nga e kaluara tek e ardhmja

Sot, shtypi ushtarak shqiptar:

- ruan traditën 94-vjeçare të komunikimit të mbrojtjes,
 - pasqyron misionin modern të FA-së,
 - kontribuon në edukimin e brezave të rinj,
 - formon kulturën e sigurisë në shoqëri,
 - dokumenton dhe transmeton identitetin e mbrojtjes kombëtare.
- “Shtypi ushtarak është vetë historia e jetës së ushtrisë shqiptare”

KOLONEL BAKI BALA, OFICER I NDERIT,

*Ze i Jetës
dhe Kujtesës*

Kolonel Baki Bala u nda nga jeta, duke lënë pas një dhimbje të thellë te familjarët, bashkudhëtarët e jetës ushtarake dhe civile, si dhe te lexuesit e tij të shumtë. Ikja e tij nuk është vetëm humbje fizike, por edhe mungesë e një zëri të veçantë, të singertë dhe të guximshëm, që diti të shndërrojë përvojën personale, sfidën dhe vuajtjen në vlerë njerëzore e artistike.

Në jetën ushtarake, kolonel Baki Bala ishte shembull i përkushtimit, disiplinës dhe ndjenjës së lartë të përgjegjësisë ndaj atdheut dhe shërbimit. Ai i përkiste atij brezi oficerësh që e shihnin uniformën jo thjesht si detyrë, por si mision dhe si kod morali. Me korrektësi, urtësi dhe vlera njerëzore, ai la gjurmë te kolegët dhe vartësit e tij, duke fituar respektin e të gjithëve.

Por Baki Bala nuk mbeti vetëm brenda kornizave të profesionit ushtarak. Ai gjeti te letërsia një mënyrë tjetër shërbimi - shërbimin ndaj njeriut, ndaj jetës dhe ndaj së vërtetës. Me romanet "Marina" dhe veçanërisht "Sikur ta dija", ai solli një prozë realiste, të pastër, pa artifica, ku sinqeriteti me lexuesin ishte vlera themelore. Në këto vepra, Baki Bala nuk kërkoi të impresionojë, por të komunikojë; nuk kërkoi të fshihet pas teknikave, por të jetë i hapur në ndjesi, rrëfim dhe emocione.

Romani "Sikur ta dija" mbetet dëshmi e rrallë e guximit njerëzor dhe artistik. Duke e kthyer përballjen me sëmundjen në art, ai na dha një mesazh të fuqishëm jete: se edhe në momentet më të vështira, njeriu mund të gjejë kuptim, dritë dhe shpresë.



Përmes personazhit të Robertit, autori na mësoi filozofinë e pranimi, të pajtimit me veten dhe të vlerësimit të çdo çasti që na jep jeta.

Në qendër të botës së tij letrare qëndronte familja, si vlerë, si strehë dhe si forcë. Bashkëshortja, fëmijët, lidhjet e forta njerëzore dhe dashuria e pakushtëzuar u shndërruan në model frymëzimi për shoqërinë e sotme, shpesh të lëkundur në vlera. Në këtë kuptim, veprat e Baki Balës janë edhe një thirrje morale, një kujtesë për rëndësinë e solidaritetit, etikës dhe qëndresës shpirtërore.

Kolonel Baki Bala u largua, por nuk u shua. Ai jeton në kujtimin e familjes së tij, në respektin e bashkëluftëtarëve të jetës ushtarake, në faqet e librave që na la dhe në mesazhin e tij të thjeshtë, por madhor: "Çdo ditë që agon, është e ardhme."

Gazeta "Ushtria" përkulet me respekt para figurës së Kolonel Baki Balës, duke nderuar një oficer të devotshëm, një shkrimtar të ndjeshëm dhe një njeri që e jetoj jetën me dinjitet, kurajë dhe dashuri.

Qoftë i përjetshëm kujtimi i tij!

Kur Ushtria Bashkon Kombin Përtej Oqeanit

Nga Filadelfia, ish-ushtarakët shqiptarë dëshmojnë se “Ushtria” mbetet faktor uniteti, kujtese dhe shprese për brezat që vijnë



NGA KOLONEL (P)
HYS HASA

FILADELFIA – Ende me gëzimin dhe entuziazmin e Festave të Nëntorit në zemrat dhe fytyrat tona, ne, ish-ushtarakët shqiptarë në pension apo të liruar, me banim në Filadelfia, të organizuar në Forumin Ushtarak, pjesë përbërëse e Shoqatës Atdhetare “Bijtë e Shqipes”, u mbledhëm për të festuar 113-vjetorin e Ushtrisë Shqiptare, një datë me rëndësi të veçantë kombëtare. Kjo festë mori një domethënie edhe më të gjerë, pasi përkoi edhe me 7-vjetorin e Ushtrisë së Kosovës, duke e shndërruar atë në një ngjarje mbarëkombëtare për komunitetin tonë.

Ky takim nuk ishte thjesht një festë përkujtimore, por një akt reflektimi, krenarie dhe uniteti. Mes emocioneve, mallit për njëri-tjetrin dhe ndjenjës së përbashkët të shërbimit, u takuam si kolegë, miq dhe bashkudhëtarë të një historie të përbashkët. U shkëmbyen urime, përshëndetje dhe lajme nga jeta familjare, ndërsa edhe bashkëshortet tona u bënë pjesë e kësaj atmosfere miqësore, duke ndarë biseda për fëmijët, nipërit dhe mbesat – dëshmi e rolit të pazëvendësueshëm të familjes në jetën e ushtarakut.

Festës iu bashkuan edhe kolegë nga Nju Jorku dhe Nju Xherisi, duke e pasuruar më tej këtë veprimtari. Të pranishëm ishin përfaqësues të Shoqatës së Ushtarakëve “Skënderbej” në Nju Jork, zv/presidentja znj. Dirka Xhakolli, e shoqëruar nga z. Astrit Xhakolli, si dhe sekretari z. Veri Talushllari, të cilët u pritën nga drejtuesit e Forumit Ushtarak në Filadelfia: kryetari z. Niko Salavaçi, sekretari z. Lutfi Bami dhe zv/kryetari z. Kastriot Hysko. Një prani e veçantë ishte edhe Kryetari i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së për Amerikën, z. Astrit Huskaj, i shoqëruar nga bashkëluftëtari i tij z. Kamber Berisha.

Veprimtaria nisi me intonimin solemn të Himnit Kombëtar Shqiptar dhe Himnit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të përcjellë me dorë në zemër nga të gjithë pjesëmarrësit. Kënga “Mora fjalë” krijoi më pas një atmosferë të thellë emocionale dhe patriotike, duke na rikujtuar rrënjët, sakrificat dhe idealet që na kanë bashkuar ndër breza.

Programi artistik vijoi me valle dhe këngë nga të gjitha trevat shqiptare, duke i dhënë festës gjallëri dhe bukuri. Në kuadër të kësaj veprimtarie, drejtuesit e Forumit Ushtarak ndanë Certifikata Mirënjohjeje për anëtarë me kontribute të veçanta në veprimtaritë e Forumit dhe të Shoqatës “Bijtë e Shqipes”. Me këtë rast u nderuan zotërinjtë Eduard Zeneli, Qamil Lako, Sazan Sula, Bujar Gjoka, Vlash Fili dhe Tajar Domi. Një mirënjohje e veçantë iu akordua sekretarit të Shoqatës “Skënderbej” në Nju Jork, z. Veri Talushllari, për kontributin e tij në forcimin e bashkëpunimit mes shoqatave dhe pasqyrimin e vazhdueshëm të veprimtarive të tyre në media. Po ashtu, nga shoqata “Oda Dibrane” u nderua z. Astrit Xhakolli.

Nëpërmjet përfaqësuesit të saj, Kolonel Astrit Huskaj, Selia Qendrore e OVL të UÇK-së, në Prishtinë, nderoi disa anëtarë të Forumit Ushtarak në Filadelfia: Petrit Zanaj, Lutfi Bami, Hys Hasa dhe Haki Çollaku, për kontributin e dhënë në Luftën për Lirinë e Kosovës dhe për promovimin e vlerave të saj në komunitet.



Kjo veprimtari ishte edhe një shtysë për reflektim më të thellë mbi rolin e Ushtrisë dhe të ish-ushtarakëve në diasporë. Ushtria Shqiptare nuk është thjesht një institucion i armatosur i shtetit; ajo është histori, kujtesë dhe përgjegjësi brezash. Që nga themelimi i saj, më 4 dhjetor 1912, ajo ka qenë shtyllë e mbijetesës së shtetit shqiptar, mbrojtëse e sovranitetit, integritetit territorial dhe dinjitetit kombëtar. Këto vlera nuk shuhen me daljen në pension apo me largimin fizik nga atdheu; ato vazhdojnë të jetojnë si kod morali dhe nderi tek ish-ushtarakët, kudo që ndodhen.

Diaspora ushtarake shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës përfaqëson një pasuri të veçantë njerëzore dhe institucionale. Ish-ushtarakët nuk janë thjesht emigrantë; ata janë bartës të përvojës shtetformuese, të disiplinës dhe të etikës së shërbimit publik. Përmes veprimtarive të tyre, ata ruajnë lidhjen shpirtërore me atdheun, promovojnë vlerat kombëtare dhe përfaqësojnë me dinjitet Shqipërinë dhe Kosovën në diasporë.

Një dimension i veçantë i kësaj feste ishte edhe përkujtimi i Ushtrisë së Kosovës. Shtatë vjet nga

themelimi i saj janë dëshmi se sakrifica u shndërrua në shtet. Veteranët e UÇK-së, sot aktivë edhe në diasporë, mbeten dëshmitarë të gjallë të çmimit të lirisë dhe bartës të një mesazhi të fuqishëm për brezat e rinj. Pas rreth katër orësh aktiviteti të ngrohtë, dinjitoz dhe të mirë organizuar, u ndamë miqësisht me urimin për t'u ritakuar në veprimtari të tjera atdhetare. Ky takim ishte një tjetër dëshmi se ushtria, përtej uniformës dhe kohës, mbetet një faktor bashkimi kombëtar. Ushtria nuk është vetëm e shkuara dhe e tashmja jonë. Ajo është edhe e ardhmja. Dhe kjo e ardhme ndërtohet mbi kujtesën, vlerat dhe përgjegjësinë për t'ua përcjellë këto brezave që vijnë, një mision që nuk njeh kufij gjeografikë, as kohorë.



100 VJET FORCË DETARE SHQIPTARE

Një shekull në shërbim të detit, atdheut dhe sigurisë kombëtare

Historia e Forcës Detare Shqiptare është historia e marrëdhënies së shqiptarëve me detin, një lidhje e lashtë sa vetë qytetërimi ynë. Nga anijet ilire që lundronin në Adriatik e Jon, deri te anijet moderne patrulluese që sot operojnë nën flamurin e NATO-s, Forca Detare Shqiptare përfaqëson vazhdimësinë e një tradite detarie mbi 2000-vjeçare dhe një shekull organizimi shtetëror modern.

100-vjetori i Forcës Detare nuk është vetëm një përvjetor kronologjik, por një moment reflektimi mbi sakrificat, përkushtimin dhe profesionalizmin e brezave të detarëve shqiptarë që kanë ruajtur sovranitetin detar të vendit.

TRADITA E LASHTË E DETARISË SHQIPTARE

Ilirët dhe fuqia detare

Detaria shqiptare i ka rrënjët e saj në lashtësinë ilire. Fiset ilire, veçanërisht Japodët dhe më pas Liburnët, u shquan për një detari të zhvilluar dhe për ndërtimin e anijeve luftarake të shpejta, të njohura si liburnide. Këto anije u bënë aq të famshme sa më vonë u adoptuan edhe nga flota romake.

Nën mbretërinë e Agronit, Teutës dhe Gentit, fuqia detare ilire njohu kulmin e saj. Mbretëresha Teutë mbetet një nga figurat më emblematike të historisë detare në Mesdhe, duke sfiduar fuqitë e mëdha të kohës për kontrollin e rrugëve detare.

Kjo trashëgimi e lashtë do të mbetej për shekuj një kujtesë historike, deri në momentin kur shteti shqiptar modern do të përpiquej ta ringjallte në forma institucionale.

SHPALLJA E PAVARËSISË DHE FILLET E FORCËS DETARE (1912-1925)

Me Shpalljen e Pavarësisë, më 28 Nëntor 1912, Qeveria e Ismail Qemalit ndërmori përpjekjet e para për krijimin e një force detare shqiptare. Megjithatë, shpërthimi i Luftës së Parë Botërore dhe rrethanat e vështira politike e ekonomike e ndërprenë këtë proces.

Organizimi shtetëror dhe blerja e anijeve të para

Në vitin 1925, mbi bazën e Statutit të Shqipërisë të miratuar më 7 mars, filloi organizimi i ushtrisë shqiptare. U krijua Komanda e Përgjithshme e Fuqive, ndërsa po atë vit u dërguan katër studentë shqiptarë për studime në Itali, për të plotësuar nevojat e Flotës Ushtarake për oficerë marine.

Më 25 dhjetor 1925, Parlamenti shqiptar miratoi buxhetin për blerjen e dy anijeve ushtarake 190-tonëshe nga Italia, të cilat u pagëzuan me emrat "Shqipnia" dhe "Skanderbeg". Ky akt shënon lindjen formale të Flotës Ushtarake Shqiptare.

RINGRITJA PAS ÇLIRIMIT – 1945, VITI I RILINDJES DETARE

Çlirimi i Shqipërisë në nëntor 1944 e gjeti flotën shqiptare në gjendje tejet të vështirë. Infrastruktura ishte e shkatërruar dhe mjetet detare pothuajse të papërdorshme.

Më 23 shkurt 1945, vetëm tre muaj pas çlirimit, u krijua Seksioni i Marinës Ushtarake Shqiptare, me në krye kapitenin e parë të marinës Abdi Mati, një figurë kyçe e ringritjes së Forcës Detare.

Nën drejtimin e tij, për disa muaj u punua për nxjerrjen nga uji të dy motoskafëve të mbytur. Më 15 gusht 1945, u përurua hedhja në ujë e motoskafëve MS-10 dhe MS-12, të cilat u armatosën dhe nisën patrullimin e ujërave bregdetare në Vlorë dhe Sarandë.

Kjo datë shënon ringritjen zyrtare të Marinës Ushtarake Shqiptare, ndërsa po atë ditë u ngrit simbolikisht flamuri i Marinës Luftarake Shqiptare për herë të parë pas çlirimit.

NDËRTIMI I FLOTËS MODERNE – EPOKA E NËNDETËSEVE (1957-1960)

Në fund të nëntorit 1957, në Durrës u zhvillua ceremonia e inaugurimit të Brigadës së Parë të



Nëndetëseve. Katër nëndetëset e para mbërritën në bazën e Pashalimanit në shtator 1958.

Më 17 shtator 1958, në një ceremoni historike, u ul flamuri i Bashkimit Sovjetik dhe në nëndetëse u ngrit flamuri shqiptar. Në fillim të vitit 1960, brigadës iu shtuan edhe 8 nëndetëse të tjera të tipit Projekti 613 (klasi Whiskey).

Po në vitin 1960, në Vlorë u hap Shkolla e Marinës, sot Akademia e Detarisë, institucioni që përgatiti breza të tërë oficerësh dhe specialistësh të Forcës Detare.

ZHVILLIMI DHE KONSOLIDIMI (1961-1990)

Periudha 1961-1980 shënoi zgjerimin dhe modernizimin e Forcave Detare, me kompletim me anije siluruese, njësi luftarake dhe krijimin e reparteve të Kërkim-Shpëtimit.

U ngrit Shërbimi Hidrografik, i cili ndërtoi një rrjet fenerësh në gjithë bregdetin shqiptar



dhe modernizoi pikat sinjalo-vrojtues me rrjete radiolokatorësh.

Gjatë viteve 1980-1990, Forca Detare u fokusua në ruajtjen e gatishmërisë teknike të flotës, ku një rol kyç luajti Kantieri Detar i Riparimit në Pashaliman.

TRANZICIONI DHE SFIDAT (1990-1997)

Pas vitit 1990, me rënien e sistemit komunist, Forca Detare u përball me nevojën për ristrukturim dhe rikonceptim, me synim integrimin në strukturat euroatlantike.

Në këtë periudhë u intensifikua bashkëpunimi me flotat perëndimore dhe NATO-n, përmes stërvitjeve të përbashkëta SAREX dhe MAREX, ku efektivat shqiptarë treguan profesionalizëm të lartë.

RINGRITJA PAS KRIZËS SË MARSIT 1997

Ngjarjet tragjike të marsit 1997 shkaktuan dëme të rënda në Forcën Detare. Falë përkushtimit të personelit dhe ndihmës së partnerëve perëndimorë (SHBA, Itali, Turqi, Greqi), u arrit ringritja e distrikteve detare të Durrësit, Vlorës, Sarandës dhe Shëngjinit.

Në vitin 1998, SHBA dhuroi 5 motovedeta, ndërsa në 2002, Italia dhuroi 6 motovedeta, të cilat u integruan në strukturën e Rojës Bregdetare Shqiptare.

Operacioni antitrafik "PUNA" në gusht 2002 shënoi një sukses të madh në luftën kundër krimit të organizuar

MODERNIZIMI DHE NATO (2007-SOT)

Më 13 nëntor 2007, u nënshkrua marrëveshja me Damen Shipyards për ndërtimin e 4 anijeve patrulluese "Stan Patrol 4207". Anija e parë, "Iliria", mbërriti në gusht 2008, ndërsa "Oriku", "Lisus" dhe "Butrinti" u ndërtuan në Pashaliman.

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, në vitin 2009, i dha një dimension të ri rolit të Forcës Detare. Anijet shqiptare morën pjesë në misione në Detin Egje, duke shpëtuar mijëra emigrantë të paligjshëm.

Në vitin 2025, Forca Detare u pasurua me korvetën "Libra", të klasit "Cassiopea", dhuratë nga Qeveria Italiane.

100 vjet Forcë Detare Shqiptare janë 100 vjet histori, sakrificë dhe krenari kombëtare. Nga liburnidet ilire te anijet moderne të NATO-s, Forca Detare ka qenë dhe mbetet një shtyllë e rëndësishme e sigurisë kombëtare dhe një ambasadore e denjë e Shqipërisë në detet e botës.

Një datë që shënon kthesë historike

Më 14 dhjetor 1955, Shqipëria u pranua zyrtarisht si anëtare e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB). Ky akt përbën një nga momentet më të rëndësishme të historisë së shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare pas Luftës së Dytë Botërore. Për një vend të vogël, të dalë nga lufta me plagë të thella ekonomike dhe shoqërore, i pozicionuar në një zonë strategjike të Ballkanit dhe i qeverisur nga një regjim komunist në kulmin e Luftës së Ftohtë, anëtarësimi në OKB nuk ishte thjesht një procedurë formale, por një betejë e gjatë politike dhe diplomatike.

Pranimi i Shqipërisë në OKB shënoi njohjen ndërkombëtare të sovranitetit të saj, thyerjen e izolimit diplomatik dhe përfshirjen e vendit në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare, në një kohë kur bota ishte e ndarë në dy blloqe të mëdha kundërshtarë.

Shqipëria pas Luftës së Dytë Botërore dhe rruga drejt OKB-së

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Shqipëria doli nga konflikti si një nga vendet më të shkatërruara në Evropë. Megjithatë, ajo kishte një avantazh politik: ishte çliruar kryesisht me forcat e veta dhe kishte krijuar një pushtet të ri shtetëror, të dalë nga Lufta Nacionalçlirimtare.

Në vitin 1945, qeveria shqiptare aplikoi për herë të parë për anëtarësim në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, me synimin për të siguruar njohjen ndërkombëtare dhe për të qenë pjesë e rendit të ri botëror që po formësohej pas luftës. Por realiteti ndërkombëtar ishte i ndërlikuar. Fillimi i Luftës së Ftohtë, përplasja ideologjike mes Lindjes komuniste dhe Perëndimit kapitalist, si dhe mosbesimi i fuqive perëndimore ndaj regjimeve komuniste në Evropën Lindore, bënë që kërkesa e Shqipërisë të refuzohej.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe dhe Franca shprehën rezerva të forta ndaj anëtarësimit të Shqipërisë, duke e lidhur këtë çështje me karakterin e regjimit politik, me çështje pronësie, si dhe me marrëdhëniet e Tiranës me Jugosllavinë dhe më pas me Bashkimin Sovjetik.

Bllokadat politike dhe izolimi diplomatik (1945–1955)

Gjatë dhjetë viteve të para pas luftës, Shqipëria mbeti jashtë OKB-së, pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme diplomatike. Në vitin 1951, kundërshtimi i vendeve perëndimore u rikonfirmua. Anëtarësimi i Shqipërisë u bë peng i rivaliteteve globale, ku çdo vend i vogël shihej si pjesë e ekuilibrave strategjikë mes dy blloqeve.

Në këtë periudhë, Shqipëria u mbështet kryesisht në marrëdhëniet me vendet e kampit socialist, veçanërisht me Bashkimin Sovjetik. Megjithatë, përjashtimi nga OKB-ja e kufizonte ndjeshëm praninë dhe zërin e saj në arenën ndërkombëtare, duke e lënë vendin të ekspozuar ndaj presioneve politike dhe diplomatike.

Ndryshimi i klimës ndërkombëtare dhe kompromisi i vitit 1955

Në mesin e viteve '50, situata ndërkombëtare filloi të ndryshojë. Pas vdekjes së Stalinit dhe zhvillimeve të reja politike në kampin socialist, u shfaqën përpjekje për uljen e tensioneve mes SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik. Koncepti i

14 Dhjetor 1955 - Shqipëria hyn në Organizatën e Kombeve të Bashkuara: Një fitore diplomatike në një botë të ndarë



“bashkëjetesës paqësore” krijoi hapësira për kompromis edhe në çështje të ngrira prej vitesh.

Në këtë kontekst, u arrit një marrëveshje për pranimin njëkohësisht në OKB të një grupi shtetesh nga të dy blloqet. Më 14 dhjetor 1955, Shqipëria, së bashku me nëntë vende të tjera, u pranua si anëtare e OKB-së. Ky vendim ishte rezultat i një kompromisi politik mes Lindjes dhe Perëndimit, që synonte të shmangte bllokadat e vazhdueshme dhe të forconte rolin e OKB-së si organizatë universale.

Domethënia e anëtarësimit për Shqipërinë

Pranimi në OKB kishte një rëndësi të shumëfishtë për Shqipërinë:

- Njohje ndërkombëtare e sovranitetit të shtetit shqiptar;
- Dalje nga izolimi diplomatik dhe përfshirje në forumet globale;
- Mundësi për mbrojtjen e interesave kombëtare në një platformë ndërkombëtare;
- Rritje e prestigjit politik të vendit në arenën botërore.

Anëtarësimi në OKB i dha Shqipërisë të drejtën e pjesëmarrjes në Asamblenë e Përgjithshme, në komisione dhe në debate që preknin paqen, sigurinë dhe zhvillimin ndërkombëtar.

Përpjekjet për afrimin me Perëndimin

Në të njëjtën kohë me anëtarësimin në OKB, qeveria shqiptare u përpoq të shfrytëzonte klimën e re ndërkombëtare për të përmirësuar marrëdhëniet me vendet perëndimore. Përmes legatës franceze, Tirana i shprehu Shteteve të Bashkuara të Amerikës

dhe Britanisë së Madhe gatishmërinë për të vendosur marrëdhënie diplomatike.

Hapja e misionit shqiptar në Nju Jork krijoi mundësi për kontakte të drejtpërdrejta me diplomatë dhe përfaqësues zyrtarë amerikanë. Megjithatë, këto përpjekje hasën në kufizime politike. Në shkurt 1956, Departamenti Amerikan i Shtetit njoftoi se SHBA nuk kishte plane për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Shqipërinë, duke reflektuar vazhdimin e tensioneve ideologjike.

Shqipëria në OKB: një zë i vogël, por i pranishëm

Megjithëse një vend i vogël, Shqipëria filloi të përdorte tribunën e OKB-së për të shprehur qëndrimet e saj politike, për të mbështetur çështje të sovranitetit, të barazisë mes shteteve dhe të dekolonizimit. Prania në OKB forcoi ndjenjën e legjitimitetit ndërkombëtar dhe i dha diplomacisë shqiptare një dimension të ri.

Trashëgimia e 14 dhjetorit 1955

14 dhjetori 1955 mbetet një datë kyçe në historinë e diplomacisë shqiptare. Ai simbolizon jo vetëm një fitore politike në një botë të polarizuar, por edhe aftësinë e një shteti të vogël për të gjetur hapësirë në sistemin ndërkombëtar përmes diplomacisë dhe kompromisit.

Sot, kjo datë përkujtohet si një moment që vulosi përfshirjen e Shqipërisë në familjen e kombeve dhe hapi një kapitull të ri në marrëdhëniet e saj me botën. Në historinë e shtetit shqiptar, anëtarësimi në OKB mbetet një dëshmi se pavarësisht vështirësive, sovraniteti dhe prania ndërkombëtare janë fitore që ndërtohen me këmbëngulje dhe durim.

Akademitë ushtarake më prestigjioze në botë



Kolegji RAF Cranwell

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, kolegji u mbyll dhe mjediset e tij u përdorën si shkollë trajnimi për fluturim. Asi i fluturimit të kohës së luftës, Sir Douglas Bader, u trajnuar në RAF Cranwell. Mbreti Charles III ndoqi trajnimin si pilot reaktiv në Cranwell, por kreu trajnimin e tij si oficer në Kolegjin Mbretëror Detar Britannia, Dartmouth.

Trajnimi në Cranwell përfshin një kurs sfidues 24-javor të hartuar për të zhvilluar aftësi udhëheqëse dhe menaxhimi dhe për të zgjedhur gjeneratën e ardhshme të oficerëve të RAF.



Kolegji Mbretëror Detar “Britannia”

I vendosur në një kodër me pamje nga porti i Dartmouth në Devon, Kolegji Mbretëror Detar “Britannia” filloi trajnimin e oficerëve detarë në vitin 1863. I njohur zakonisht si Dartmouth, kolegji është një nga qendrat ushtarake më prestigjioze të të nxëniet në Mbretërinë e Bashkuar.

Princi Philip, Duka Edinburgh dhe Princi Andrew renditen midis mbretërve britanikë që janë diplomuar në Dartmouth. Një i diplomuar shumë më famëkeq ishte Guy Burgess, një anëtar i rrjetit të spiunëve Cambridge Five që veprroi nga mesi i viteve 1930 deri në vitet e para të epokës së Luftës së Ftohtë.

Kadetët e pranuar për trajnim oficerësh në Dartmouth mund të presin një kurs të mundimshëm me dy pjesë që do të sfidojë vendosmërinë mendore dhe fizike. Marina Mbretërore Britanike është një nga shërbimet ushtarake më të famshme në botë dhe trajnimi për një jetë në det do të testojë kufijtë edhe të kadetëve më të përgatitur.



Akademia Kombëtare e Mbrojtjes e Japonisë

E vendosur në Yokosuka, Prefektura Kanagawa, Akademia Kombëtare e Mbrojtjes e Japonisë u hap në vitin 1952 si Akademia Kombëtare e Sigurisë dhe u riemërua Akademia Kombëtare e Mbrojtjes vitin pasardhës.

Qëllimi i saj është të edukojë dhe trajnojë studentët që do të shërbejnë si oficerë në tre shërbimet e Forcave të Vetëmbrojtjes së Japonisë. Është interesante se ish-sekretarja amerikane e shtetit Condoleezza Rice pati një pozicion profesoreshe vizitore tre-javore në akademi në vitin 1984, një përvojë që ajo e kujtoi në kujtimet e saj të vitit 2010 “Njerëz të Jashtëzakonshëm, të Zakonshëm”.

Nuk kërkohet një provim pranimit për t’u anëtarësuar në Akademinë Kombëtare të Mbrojtjes së Japonisë, por të gjithë aplikantët duhet të jenë shtetas japonezë.

Kolegji Mbretëror Ushtarak i Kanadasë

I themeluar në vitin 1876, Kolegji Mbretëror Ushtarak i Kanadasë komandon një pozicion në gadishullin Point Frederick në Kingston, Ontario.

Kolegji Mbretëror Ushtarak i Kanadasë është kolegji ushtarak më i vjetër që jep diploma në Komonuelth. Por marrja e këtij kualifikimi nuk është aspak e lehtë. Është një institucion shumë selektiv, me një normë pranimit prej pak mbi 10%.

Që nga themelimi i tij, shumica e oficerëve të lartë ushtarakë të Kanadasë kanë kaluar nëpër kolegji. Një individ i shquar është Kate Armstrong, e cila u diplomua si kapiten dhe që më vonë është autore e librit “Fregata e Gurit: Kadetja e Parë Femër e Kolegjit Mbretëror Ushtarak flet”, botuar në vitin 2019.



Akademia Ushtarake e Koresë

E themeluar në vitin 1946, Akademia Ushtarake Koreane me seli në Seul të Koresë së Jugut, është akademia ushtarake kryesore e vendit. Gjatë Luftës Koreane, Gjenerali James Van Fleet, i rekrutuar nga “West Point”, propozoi një akademi me një kurs katërvjeçar të modeluar sipas akademisë ushtarake shumë prestigjioze me seli në Virxhinia. Është ky program që ndjekin kadetët sot.

Ushtarët e rekrutuar në shërbim ushtarak të Koresë së Jugut janë të trajnuar mirë dhe të disiplinuar mirë. Prandaj, oficerët shërbejnë si modele të rëndësishme dhe akademia prodhon numrin më të madh të oficerëve të lartë në ushtrinë e Koresë së Jugut.




Akademia Australiane e Forcave të Mbrojtjes

Me seli në Canberra, kryeqytetin e vendit, Akademia e Forcave të Mbrojtjes Australiane (ADFA) ofron arsim ushtarak dhe akademik për oficerët e rinj.

E themeluar në vitin 1986, ADFA është në thelb një akademi ushtarake me tre shërbime që ofron hyrje në Marinën Mbretërore Australiane (RAN), Ushtrinë Australiane ose Forcat Ajrore Mbretërore Australiane (RAAF).

Arsimi akademik i ADFA-s drejtohet nga Universiteti i Uellsit të Ri Jugor. Trajnimi ushtarak fillon me një kurs rigoroz hyrës pesë-javor. Nëse e kaloni këtë kurs, kadetët kalojnë në Trajnimin e Familjes së Vitit të Parë.



Si Qytetet Inteligjente dhe Bazat Ushtarake përballen me të njëjtat sfida teknologjike

Nga infrastruktura e sigurisë tek menaxhimi i trafikut, teknologjia inteligjente po shndërrohet në një urë lidhëse mes bazave ushtarake dhe qyteteve moderne. Në një kohë kur digjitalizimi po përshkon çdo aspekt të jetës, është e qartë se sfidat dhe zgjidhjet e teknologjisë inteligjente nuk janë më ekskluzivitet i sektorit civil apo atij ushtarak – ato janë të përbashkëta.

Sfida të Përbashkëta: Nga Kërcënimet Kibernetike deri tek Menaxhimi i Infrastrukturës Kritike

- Siguria kibernetike si fronti i parë i mbrojtjes

Qytetet inteligjente dhe bazat ushtarake përballen me kërcënime të ngjashme: sulme kibernetike që mund të paralizojnë sistemet e energjisë, transportit apo komunikimit. Një ndërhyrje e tillë mund të ketë pasoja të rënda, si për jetën civile ashtu edhe për operacionet ushtarake. Në këtë kuadër, mbrojtja e rrjeteve digjitale është një prioritet absolut.

- Menaxhimi i të dhënave masive dhe sfida e privatësisë

Sensorët, kamerat dhe sistemet e monitorimit gjenerojnë sasi të mëdha të dhënash. Sfida qëndron tek përpunimi i tyre në kohë reale, duke siguruar privatësinë e qytetarëve dhe njëkohësisht duke ruajtur sekretet ushtarake. Balanca mes transparencës dhe sigurisë është një dilemë e përhershme.

- Infrastruktura e energjisë si themel i funksionimit

Qytetet moderne dhe bazat ushtarake varen nga rrjete energjie të qëndrueshme. Krizat energjetike, sulmet ndaj rrjeteve elektrike apo mungesa e burimeve të rinovueshme janë sfida të përbashkëta që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme.

- Mobiliteti dhe logjistika në kohë reale

Trafiku urban dhe lëvizja e trupave ushtarake kanë nevojë për sisteme inteligjente që parashikojnë flukset, shmangin bllokimet dhe optimizojnë transportin. Pa këto sisteme, kaosi logjistik është i pashmangshëm.

Zgjidhje të Teknologjisë Inteligjente: Nga Inteligjenca Artificiale tek Energjia e Gjelbër

- Sisteme të integruara të sigurisë kibernetike dhe fizike

Përdorimi i inteligjencës artificiale për të zbuluar modele të dyshimta në rrjetet kibernetike është një zgjidhje që po aplikohet si në qytete ashtu edhe në bazat ushtarake. Qytetet mund të mbrojnë të dhënat e qytetarëve, ndërsa bazat ushtarake mund të parandalojnë infiltrimet strategjike.

- Platforma të përbashkëta të të dhënave për reagim më të shpejtë

Krijimi i qendrave të përbashkëta të analizës së të dhënave, ku informacioni nga sensorët urbanë dhe ata ushtarakë mund të

kombinohet për të përmirësuar reagimin ndaj emergjencave, është një hap drejt bashkëpunimit të vërtetë.

- Energjia e gjelbër dhe rrjetet e decentralizuara

Përdorimi i paneleve diellore, baterive inteligjente dhe rrjeteve mikro-energjietike jo vetëm që redukton varësinë nga burimet tradicionale, por rrit edhe sigurinë në rast krizash. Kjo është një fushë ku qytetet dhe ushtria mund të bashkëpunojnë ngushtë.

- Transporti autonom si zgjidhje e dyfishtë

Qytetet po testojnë autobusë dhe taksi autonome, ndërsa ushtria po eksperimenton me automjete pa pilot për logjistikë dhe furnizime. Teknologjia është e njëjtë, vetëm aplikimi ndryshon, duke treguar se inovacioni nuk ka kufij sektorialë.

Bashkëpunimi si Çelës: Nga Menaxhimi i Krizave tek Komunikimi i Sigurt

Në vend që të zhvillojnë zgjidhje të ndara, qytetet dhe bazat ushtarake po kuptojnë se bashkëpunimi është më efikas. Një sistem inteligjent i menaxhimit të krizave mund të shërbejë si për evakuimin e qytetarëve, ashtu edhe për

mobilizimin e trupave. Po kështu, teknologjitë e komunikimit të sigurt mund të përdoren si në administratën civile, ashtu edhe në operacionet ushtarake. Ky bashkëpunim jo vetëm që kursen resurse, por krijon një ekosistem të integruar të sigurisë.

Një Ekosistem i Ri Digjital ku Kufijtë Zhduken

Në epokën e teknologjisë inteligjente, kufiri mes qytetit dhe bazës ushtarake po bëhet gjithnjë e më i paqartë. Sfida të përbashkëta kërkojnë zgjidhje të përbashkëta. Qytetet dhe ushtria, dikur dy botë të ndara, sot janë pjesë e të njëjtit ekosistem digjital. Dhe ky ekosistem, për të qenë i sigurt dhe funksional, kërkon bashkëpunim, transparencë dhe inovacion të vazhdueshëm.



SENSORËT, KAMERAT DHE
SISTEMET E MONITORIMIT
GJENEROJNË SASI TË
MËDHA TË DHËNASH.
SFIDA QËNDRON TEK
PËRPUNIMI I TYRE NË KOHË
REALE, DUKE SIGURUAR
PRIVATËSINË E QYTETARËVE
DHE NJËKOHËSISHT DUKE
RUAJTUR SEKRETET
USHTARAKE.





QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT ka filluar regjistrimin e kandidatëve për: **200 USHTARË/DETARË AKTIVË**

Stërvitja Individuale Bazë do të bëhet në periudhën 09.02.2017-17.04.2026

Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri më 16 janar 2026

Kontaktoni në:

+355 68 34 04 896

+355 42 348 588